Aftësitë për Punësim Rural (S4RE)

HELVETAS Swiss Intercooperation KOSOVO

Raporti Vjetor 2014

Prishtinë, Shkurt 2015

Tabela e Përmbajtjes

1. INFORMACIONET THEMELORE 4

2. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE 5

3. REZULTATET PËR SECILIN PRODHIM 7

3.1 PRODHIMI 1: GRUPET MËSIMORE TË CILAT KANË PËR CAK TË RINJTË E PAPUNËSUAR 7

3.2 PRODHIMI 2: PROGRAMET E TRAJNIMIT TË SEKTORIT PRIVAT PËR PUNONJËSIT EKZISTUES DHE ATA TË RINJ..... 8

3.3 PRODHIMI 3: JANË FORCUAR HALLKAT E ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT..... 10

3.4 PRODHIMI 4: NGRITJA E KAPACITETEVE TË OFRUESVE LOKAL TË SHËRBIMEVE 11

3.5 TEMAT E TËRTHORTA 11

4. MENAXHIMI I PROJEKTIT 12

4.1 MENAXHIMI I PROJEKTIT SIGURON ZBATIMIN EFIKAS TË AKTIVITETEVE, RRITË ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË STAFIT DHE KAPITALIZMIN E REZULTATEVE..... 12

4.4 PARTNERËT E PROJEKTIT 13

5. MËSIMET E NXJERRA..... 13

7. BUXHETI..... 15

8. PASQYRA FINANCIARE 16

8. SHTOJCAT..... 17

SHTOJCA 1: FLETA MONITORUESE PËR S4RE 18

SHTOJCA 2: FAKTE dhe SHIFRA PËR PRODHIMIN 1..... 22

SHTOJCA 3: FAKTE dhe SHIFRA PËR PRODHIMIN 2..... 23

SHTOJCA 4: FAKTE dhe SHIFRA PËR PRODHIMIN 3..... 24

SHTOJCA 5: PËRKUFIZIMI I 'PUNËSIMIT' (AKTIVITETI EKONOMIK)..... 25

SHTOJCA 6: RASTET STUDIMORE DHE TREGIMET E SUKSESIT..... 26

SHTOJCA 7: FOTOGRAFITË..... 33

Lista e Shkurtesave

S4RE	Aftësitë për Punësim Rural
GM	Grupi Mësimor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
QATP	Qendra e Arsimit dhe Trajnimit Profesional
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
PMJD	Produkte Malore Jo-Drusore
SEC	Senior Experts Corps - Swisscontact
RAM	Rishikimi Afatmesëm
USAID	Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
MAFRD	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
ZV	Zinxhiri i Vlerave
PVV	Plani Vjetor i Veprimit

Harta me Zonat e Ndërhyrjes së Projektit



1. Informacionet Themelore

Vendi: Kosovë	**Emri i projektit:**
Domeni i Strategjisë së Bashkëpunimit: Aftësitë dhe Punësimi	Aftësitë për Punësim Rural - S4RE

Synimi:	Reduktimi i Varfërisë në Kosovën rurale nëpërmjet zhvillimit të aftësimeve dhe trajnimeve të synuara, që çon në rritjen e punësueshmërisë
Prodhimet (OC): *(Objektivi i Projektit, Qëllimi)*	OC 1: Grupet mësimore të cilat kanë për cak njerëzit e rinj të papunësuar OC 2: Programet e trajnimit në sektorin privat për punonjësit ekzistues dhe ata të rinj OC 3: Janë forcuar hallkat e zinxhirit të furnizimit OC 4: Ngritja e kapaciteteve të ofruesve lokal të shërbimeve

Kohëzgjatja e fazës së Projektit: 01.01.2013 – 31.12.2015	**Periudha raportuese:** 01.01.2014 – 31.12.2014

Buxheti në fazë (CHF)	1,452,306.24	**Buxheti në vitin 2014 (CHF)** **Shpenzuar në vitin 2014 (CHF)**	457,108 447,277

Organizatat implementuese: **Partnerët kryesor kombëtarë -** Bizneset kombëtare dhe lokale, MPMS, Komunat (Drejtoria e Rinise, Kulturës dhe Sportit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik), Qendrat/Zyrat Publike të Punësimit, Ofruesit e Trajnimeve	**Partnerët kryesor ndërkombëtar -** UNDP – Projekti InterDev, CARITAS Zvicër – Integrimi i Pakicave dhe Zhvillimi Rajonal (IPZHR)

Koordinator i Projektit:	z. Luan Hoti	**Numri i pjesëtareve të stafit të projektit:**	Të huaj: 0 Vendor: 4

2. Përmbledhja Ekzekutive

Projekti Aftësitë për Punësim Rural (S4RE), i financuar nga Fondacioni Medicor, Fondacioni Julius Bear dhe HELVETAS Swiss Intercooperation, ka vazhduar implementimin e vitit të dytë.

S4RE ka angazhuar 6 lehtësues të terrenit (4 të lartë dhe 2 junior) me kontratë shërbimi njëvjeçare, në mënyrë që të forcojnë llogaridhënien dhe lidhjen në mes të lehtësuesve të projektit dhe të terrenit. Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte që përmes lehtësuesve të terrenit të ndikohet në krijimin e vetëdijes më të mirë dhe ndikim më i madh tek grupet rinore të katër komunave. Përveç punës me Grupet Mësimore, lehtësuesit kërkohet të punojnë ngushtë me akterët tjerë të zinxhirëve të vlerave dhe të bizneseve aktive në komuna.

Për vlerësimin e mundësive të tregut, për secilin GM që është krijuar, është përdorur Vlerësimi i Shpejtë i Tregut (VSHT).

Marrëdhëniet me institucionet publike, p.sh. me komunat dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kanë vazhduar të forcohen jo vetëm në çështjet formale të nënshkrimit të dokumentit të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM), por edhe në aktivitetet konkrete të përbashkëta.

Sistemi i sigurimit të cilësisë së trajnimit është duke u përmirësuar. Trajnimi për grupin mësimor të floktarisë në Dragash është monitoruar nga ekspertet për floktari të Qendrës së Trajnimit Profesional (QTP).

Katharina Walker dhe Peter Porten nga HELVETAS Swiss Intercooperation, kanë bërë rishikimin afatmesëm të projektit, nga 27 tetor deri më 1 nëntor 2014. Qëllimi i rishikimit ka qenë vlerësimi i projektit në fazën e mesme të projektit dhe ofrimi i këshillave për periudhën e mbetur. Ekipi i rishikimit ka analizuar dokumentet kryesore të projektit dhe ka kryer intervista me palë të ndryshme të interesit. Rishikimi pikë së pari synon këshillimin e projektit për drejtimin periudhës së mbetur.

Rishikimi tregon se projekti po arrin rezultate të prekshme. Duke përdorur një mendësi të mundësisë dhe qasjes, projekti në fakt identifikon dhe trajton punësimin dhe mundësitë e gjenerimit të të ardhurave për të rinjtë rural të papunë dhe grupet formale dhe joformale të zinxhirëve të furnizimit. Pilot-Ndërhyrja aktuale është rregulluar mirë për tu bërë një projekt model. Prandaj, ekipi i rishikimit sugjeron zgjatjen e projektit edhe pas vitit 2015 dhe angazhimin drejt fazës tjetër, e cila do të vazhdonte strategjinë premtuese të ndërhyrjes duke përfshirë metodologjitë e veta inovative, por duke trajtuar më shumë nivelin sistematik të ndërhyrjes.

Një udhëtim studimor në Afrikë (Tanzani) i dy anëtarëve të stafit dhe pjesëmarrja e dy anëtarëve të tjerë të projektit në një trajnim në Holandë, ka ndikuar në të kuptuarit më të mirë të konceptit të grupeve mësimore, si dhe në lehtësimin (facilitimin) e grupeve.

S4RE vazhdon të mbështetet nga këshilltarët ndërkombëtarë. Në muajin Janar është realizuar një vizitë ndihmuese nga Këshilltari Ndërkombëtar i Projektit, z. Stewart Pettigrew, për të përsosur qasjet e implementimit dhe Planin Vjetor të Veprimit (PVV). Pastaj është realizuar edhe një vizite tjetër e Këshilltarëve Ndërkombëtar të zyrës kryesore të Projektit HELVETAS Swiss Intercooperation, z. Peter Porten dhe znj. Katharina Walker.

S4RE ka angazhuar sërish dy praktikantë, një nga Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë dhe një nga Kolegji RIINVEST për një periudhë 3 mujore për secilin prej tyre. Qëllimi i këtyre praktikave është që ti ofrojë studentëve të vitit të fundit përvoja praktike në punën e projektit, ndërsa në të njëjtën kohë rritjen e burimeve të stafit për projektin.

Disa nga arritjet kryesore të projektit gjatë dy viteve të zbatimit të tij, kanë qenë si në vijim:

Prodhimi 1:

- 75 GM kanë kompletuar ciklin mësimor
- 792 të rinj kanë ndërmarrë trajnime të aftësive jetësore, teknike dhe të ndërmarrësisë (janë synuar 800)
- Përpara implementimit të trajnimit me secilën GM, janë kryer VSHT-të
- Të gjitha kontratat me personat e burimeve bazohen në rezultate – (promovimi i mentorimit)
- 32% janë femra (janë synuar 50%) dhe 33% nga pakicat (janë synuar 25%).
- Në vitet (2013-2014), 46% kanë kaluar në aktivitete të gjenerimit të të ardhurave.
- Është promovuar dhe implementuar sigurimi i cilësisë së trajnimit;
- 58% e 792 të rinjve janë kyçur në aktivitete të agrobiznesit
- Janë mbështetur 14 GM nëpërmjet fondit të mundësisë, shtatë janë në bujqësi, dy në rrobaqepësi, dy në floktari, dy në TI dhe një në video dizajn. Deri me tani, funksionale janë 13 grupe të mbështetura;

Prodhimi 2:

- Projekti ka lehtësuar trajnime për 402 punonjës, në bazë të marrëveshjes për ndarjen e shpenzimeve; prej të cilëve 99 janë të rinj;
- Lehtësime për bizneset lokale të cilat angazhojnë ekspert Swisscontact të SEC-së;
- Projekti ka ofruar asistencë teknike për 10 biznese lokale, për të përmirësuar qasjen në financa, ku 5 prej tyre kanë pranuar grante;
- Janë lehtësuar 15 biznese për themelimin e shoqatës së biznesit në komunën e Dragashit;
- Kompanitë lokale janë lehtësuar për të përmirësuar standardet e cilësisë së produkteve, p.sh. kompania SH.P.K Meka - Dragash për të marre certifikatën HACCP (Analiza e Rreziqeve dhe Pikave Kritike të Kontrollit);
- Është zhvilluar një aplikacion interneti – Vendosja e biznesit në hartë.

Prodhimi 3:

- Një numër i përgjithshëm prej 1,479 furnizuesve/prodhuesve (janë synuar 1,500), kanë rritë aftësitë profesionale dhe kushtet e punës;
- Më shumë se 80% e akterëve të zinxhirit furnizues janë lidhur me blerësit lokal/regjional;
- Është rritur bashkëpunimi i sektorit publik/privat, me inpute janë mbështetur 51 përfitues të PMJD-së, 80 prodhues të bulmetit, 10 bletarë dhe 5 prodhues të frutave;
- Me material trajnues në lidhje me marrëveshjen për ndarjen e shpenzimeve, janë mbështetur 3 grupe joformale të grave (50 përfitues nga komuniteti Serb) në prodhimin e bulmetit, mjedrës dhe mjaltit;
- Janë ndihmuar 5 prodhues individual për të përgatitur propozimet apo planet biznesore për aplikim në skemën e granteve të MBZHR, 2 tashmë kanë marr grantet.

Prodhimi 4:

- Nga ana e projektit, për herë të parë si trajnues, janë angazhuar 49 ofrues lokal të trajnimeve.
- Pas angazhimeve me projektin, në projekte të tjera janë angazhuar 9 ofrues të trajnimeve (janë synuar 3).
- Është lehtësuar (facilituar) Trajnimi TiT, për ofruesit e trajnimit
- Janë organizuar dy ngjarje të rrjetëzimit për ofruesit lokal të trajnimit.

3. REZULTATET PËR SECILIN PRODHIM

3.1 Prodhimi 1: Grupet mësimore të cilat kanë për cak të rinjtë e papunësuar

Prodhimi 1	*S4RE do të stimuloje dhe mbështesë grupet e të rinjve të papunësuar për të zhvilluar aftësitë e kërkuara jetësore, teknike dhe të ndërmarrësisë në vend; që çon në përmirësimin e punësimit dhe gjenerimin e të ardhurave*

Rezultatet e Prodhimit 1 në vitin 2014 tregojnë një arritje të madhe të objektivave në zhvillimin e aftësive jetësore, teknike dhe të ndërmarrësisë të të rinjve.

Në vitin 2014 ciklin e të mësuarit e kanë përfunduar gjithsejtë 59 Grupe Mësimore, me një numër të përgjithshëm prej 596 pjesëmarrësve. Shtojca 2 ofron informacione të detajuara në lidhje me këto grupe dhe sektorët në të cilët ata janë përfshirë.

26% e pjesëmarrësve janë femra (janë synuar 50%) dhe 36% janë nga pakicat (janë synuar 25%). Projekti S4RE synon përfundimin e trajnimit për 60% të pjesëmarrësve për tu punësuar apo për tu vetë-punësuar, dhe kah fundi i vitit 2014 gjithsejtë 60% kanë kaluar në aktivitete të cilat janë të lidhura trajnimin e tyre (shih Shtojcën 1 dhe 2).

Nga 596 pjesëmarrës, 399 ose 67% kanë zgjedhur agrobiznesin në krahasim me 33% sa kanë qenë në vitin 2013, duke treguar një reagim pozitiv për promovimin e bujqësisë, që konsiderohet si sektori me potencialin më të lartë për gjenerimin e të ardhurave. 83 të rinj kanë hyrë në bletari si fillestarë, 190 të rinj kanë krijuar pemishte të vogla me mjedër, manaferra dhe dredhëza, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 8.4 hektarëve.

Fondi i mundësisë ka lehtësuar (facilituar) iniciativat e grupeve mësimore për themelimin e bizneseve të hapura. Janë mbështetur tetë grupe mësimore, duke krijuar mundësi të vetëpunësimit për 43 individ të rinj. Idetë të cilat janë mbështetur kanë qenë në floktari, rrobaqepësi, TI, në shpezëtari, ferma të derrave dhe video/foto dizajn.

Objektivi	**Synimi**	**Arritjet**	**%**
Të trajnuarit	600	596	**100%**
Grupet Mësimore	60	59	**98%**
Pakica (25% of 600)	150	213	**142%**
Femra (50% of 600)	300	172	**57%**
Punësimi (60% of 600)	360	361	**100%**

Tabela e mësipërme tregon arritjen e objektivave në vitin 2014. Objektivi i arritjes së punësimit përfshin numrin e të rinjve të cilët pas përfundimit të trajnimit kanë hyrë në aktivitetin ekonomik që lidhet me trajnimin. Disa grupe kanë përfunduar trajnimet tek kah fundi i vitit, dhe disa janë të përfshirë në aktivitete sezonale dhe bujqësore, që do të fillojnë tek nga pranvera e vitit 2015. Kështu, S4RE do të punojë ngushtë me këto grupe dhe do të kryej aktivitete të mentorimit për të siguruar qëndrueshmërinë e aktiviteti ekonomik dhe përmbushjen e kriterit të të ardhurave.

Implikimet e rezultateve dhe procesi për veprim në vitin e ardhshëm (drejtimi**)**

Nëpërmjet metodologjisë së grupit mësimor, projekti ka vazhduar ofrimin e programit të trajnimit pjesëmarrësve të grupeve mësimore për aftësim jetësor, teknik dhe të ndërmarrësisë. Është përmirësuar dukshëm procesi i Grupit Mësimor, përfshirë edhe përdorimin e VSHT-së për të vlerësuar rastin e biznesit për idetë e grupeve mësimore. Në vitin 2015, VSHT do të përdoret vetëm kur është e nevojshme, për të identifikuar zinxhirët e rinj të vlerës apo mundësitë e hapjes së bizneseve. Ndryshimet e bëra në procesin e grupeve mësimore kanë mundësuar një rrjedhë më të mirë nga të mësuarit në drejtim të angazhimit në aktivitet ekonomik.

Marrëveshjet e bazuara në rezultate, të bëra me ofruesit e trajnimit në gjysmën e dytë të vitit 2014, përfshijnë aktivitete të mentorimit dhe kanë ndikuar në numrin e të diplomuarve të cilët kanë gjetur punë.

Kështu, për vitin 2015, për të proceduar në mënyrë më sistematike, projekti ka krijuar një koncept dokument për mentorim, për të siguruar aktivitete të fokusuara të mentorimit.

Projekti me lehtësuesit ka krijuar një sistem të besueshëm operacional, duke nënshkruar me ta kontrata në bazë të rezultatit. Në vitin 2014, projekti kishte një lehtësues në secilën komunë dhe lehtësues të rinj në Dragash dhe Kamenicë. Dy lehtësuesit e rinj të angazhuar në vitin 2014, kanë përmirësuar praninë dhe performancën e projektit në Shtërpcë dhe Novobërdë. E njëjta qasje dhe i njëjti staf do të përdoret edhe në vitin 2015.

Për shkak të mundësive të kufizuara ekonomike në industritë e tjera, projekti ka promovuar aktivitetet bujqësore. Mbështetja e grupeve mësimore me materialet e trajnimit, ishte një nxitje e përdorur për të tërhequr të rinjtë në agrobiznes dhe për të ndryshuar perceptimin ndaj aktiviteteve bujqësore. Përqendrimi në sektorin e agrobiznesit do të vazhdojë edhe në vitin 2015, duke qenë si sektori më premtues në thithjen e fuqisë së rinisë dhe për të arritur objektivat ambicioze të projektit.

Projekti ka vazhduar ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me autoritetet komunale. Në vitin 2014, MM i nënshkruar me komuna, ka lejuar përdorimin e ambienteve komunale si vende për trajnim, dhe në secilën komunë është vënë në dispozicion një hapësirë për zyre për lehtësuesit, duke siguruar një komunikim më të mirë me të rinjtë. Përveç kësaj, planet e projektit që zhvillojnë programin e trajnimit të aftësimit jetësor së bashku me zyrtarët komunal, dhe hulumtimi i mundësisë që në vitin 2015 trajnimin ta ofrojnë zyrtarët komunalë.

Sistemi i trajnimit për sigurimin e cilësisë po përmirësohet. Në vitin 2014 projekti nënshkroi një MM me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), duke lejuar bashkëpunimin me Qendrat Rajonale për Trajnim Profesional (QTP) dhe Zyrat e Punësimit. Ekspertët e QTP-së kanë monitoruar trajnimin e grupit mësimor për floktari në Dragash. Në fund të trajnimit, QTP në bashkëpunim me ekipin e projektit ka kryer testin e kompetencës dhe ka lëshuar certifikata të cilat përmbajnë vulën e MPMS. Në vitin 2015, e njëjta qasje do të përdoret në profesione të ngjashme, kurse për profesionin e bujqësisë projekti do të synojë shkëmbimin e trajnerëve. Testi i kompetencës nuk do të kryhet nga trajneri i cili ofron trajnimin; por në vend të tij do të angazhohet një trajner nga një komunë tjetër.

Gjatë viteve 2013-2014, projekti ka krijuar gjithsejtë 11 kartela të analizave të punës, duke përdorur teknikën DACUM.

3.2 Prodhimi 2: Programet e trajnimit në sektorin privat për punonjësit ekzistues dhe ata të rinj

Prodhimi 2	*S4RE do të bashkëpunojë me bizneset ekzistuese (përfshirë të vetë-punësuarit) për të zhvilluar programet e synuara të trajnimit që kanë për qëllim përmirësimin e produktivitetit, punësimit dhe kushteve të punësimit*

Strategjia e implementimit për Prodhimin 2 është ndryshuar paksa në vitin 2014. S4RE ka identifikuar dhe ka bashkëpunuar me bizneset e mëdha (me më shumë se 5 punonjës) dhe bizneset e vogla (me më pak se 5 punonjës). Duke përdorur marrëveshjet e ndarjes së shpenzimeve, projekti ka arritur rezultate më të kënaqshme në krahasim me një vit më parë. 10 biznese të mëdha dhe të vogla (të synuara kanë qenë 8), kanë rënë dakord që të formalizojnë bashkëpunimin përmes nënshkrimit të një MM.

Gjithsejtë 228 punonjës kundrejt 350 sa kanë qenë synuar, apo 82% e tyre janë trajnuar në fushën e zhvillimit të kapaciteteve. Trajnimet janë zhvilluar kryesisht në fushat e aftësive të informacionit dhe komunikimit, në aftësitë e përpunimit të drurit, të përpunimit të PMJD-ve, të menaxhimit të biznesit, të mbledhjes së fondeve, si dhe të tapicerisë.

Nga numri i punonjësve të trajnuar, 147 punonjës (nga 150 sa janë synuar) kanë qenë nga bizneset e mëdha, prej të cilëve 29 kanë qenë punonjës të rinj kundrejt 38 sa janë synuar. Bizneset e vogla janë të zhvilluara mirë dhe përbejnë pjesën më të madhe të ekonomisë lokale në komunën e synuar. Për këtë arsye, projekti është përqendruar në bizneset e vogla. NVM-të kanë marr pjesë në trajnime të ndryshme të zhvillimit te aftësive. Janë trajnuar 141

punonjës (nga 200 sa janë synuar) dhe 40 prej tyre kanë qenë punonjës të rinj, kundrejt numrit të synuar prej 50 punonjësve.

Pjesëmarrja e pakicave në trajnime është ende larg nga sa është synuar, pra 17 punonjës janë trajnuar në fusha të ndryshme (nga 88 sa janë synuar). Janë disa raste ku gratë menaxhojnë bizneset, dhe përveç kësaj është rritur edhe interesimi i grave për t'iu bashkuar programit.
Rreth 111 punëtore (gra) nga (175 sa janë synuar) kanë qenë të gatshme për të ndjekur trajnimin, kryesisht në fushën e përpunimit të PMJD-ve, në tapiceri dhe në pastiçeri. (Shtojca 1 dhe 3)

Objektivi	Synimi	Arritjet	%
Punonjës të trajnuar	350	288	**82%**
Punonjës të rinj (25% nga 350)	88	85	**97%**
Punonjës ekzistues (75% nga 350)	263	203	**77%**
Pjesëmarrës nga pakicat (25% nga 350)	88	17	**19%**
Punonjëse femra (50% nga 350)	175	111	**63%**

Projekti ka pasur disa raste ku bizneset e vogla janë grupuar së bashku me interes të përbashkët për zhvillimin e kapaciteteve. Janë formuar 8 grupe me nga 6 deri në 10 punonjës për trajnim në menaxhimin e biznesit, në mbledhjen e fondeve, si dhe në zhvillimin e planit të biznesit (shih Shtojcën 3).

Janë mbështetur 10 biznese për të pasur qasje të lehtë në burime financiare (p.sh. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/MBPZHR, BE dhe fondet lokale). Për secilin prej tyre, projekti ka lehtësuar trajnimin për zhvillimin e planit të biznesit dhe për propozimin e projektit, dhe 5 prej tyre janë mbështetur nga donatorët. Përveç kësaj, bizneseve të vogla i janë dhënë 5 grante për marketing, ku secili prej tyre ka pranuar rreth 2,000 euro për përmirësimin e promovimit të tregut.

Bizneset e mëdha janë mbështetur për të përdorur ekspertizën teknike përmes SEC-Swisscontact. Biznesi i bulmetit SH.P.K Malësia nga Kamenica është ndihmuar për të shfrytëzuar një ekspert të bulmetit nga Zvicra. Misioni 14 ditor është organizuar nga një konsulent, me ç'rast janë krijuar 5 produkte të reja dhe tani janë në dispozicion në tregun e brendshëm.

Përmes lehtësimit të S4RE, në Dragash është formuar një shoqatë formale e biznesit e përfaqësuar nga 15 biznese lokale nga fusha të ndryshme të veprimtarive. Qëllimi i përgjithshëm i shoqatës është për të lobuar në komunë dhe në vende tjera, për përmirësimin e infrastrukturës, kushteve të mjedisit të biznesit, për të pas qasje të lehtë në aftësitë e trajnimit dhe burimet financiare.

S4RE dhe komuna e Kamenicës, kanë bashkuar forcat për të mbështetur bizneset lokale për të rritur produktivitetin dhe mundësitë e punësimit. Komuna ka mbështetur DPZ Tradita me një lokal afarist dhe me një shumë të vogël të kontributit, një kompani e cila menaxhohet nga një grua dhe që merret me pastiçeri, ndërsa S4RE ka ofruar trajnim për 10 gra në ndarjen e shpenzimeve, e që pas këtij trajnimi 6 prej atyre grave patën rastin të punësohen.

Implikimet e rezultateve dhe procesi për veprim në vitin e ardhshëm

Bazuar në rezultatet dhe në mësimet e nxjerra, strategjia e implementimit do të mbetet e njejt, me disa ndryshime dhe rregullime të vogla. Për të arritur rezultate, dy zyrtar të projektit do të marrin përgjegjësitë për dy komuna për secilin. Lehtësuesit do të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e bizneseve premtuese dhe në koordinimin e aktiviteteve në nivel komunal. Pasi që sektori joformal është gjerësisht i përhapur në zonat rurale, projekti do të punojë me 5 biznese joformale në secilën komunë. S4RE do të vazhdojë të identifikoje dhe të ofrojë mundësi për biznese të ndryshme në lehtësimin e

qasjes më të lehtë në ekspert vullnetarë, shërbim ky i ofruar nga Swisscontact (Trupa e Ekspertëve të Lartë-SEC).

Projekti do të vazhdojë lehtësimin e bizneseve lokale në Shtërpcë, Kamenicë dhe Novobërdë për formimin e shoqatës së bizneseve.

Për shkak të mungesës së rezultateve të arritura në vitin 2013, Projekti konsideron se objektivi i përgjithshëm në fund të fazës është vështirë i arritshëm. Stafi i Projektit do të bëjë maksimumin për të arritur objektivin e përgjithshëm, pasi që strategjia e implementimit dhe qasja e përdorur në vitin 2014 ka treguar rezultate të mira.

3.3 Prodhimi 3: Janë forcuar hallkat e zinxhirit të furnizimit

Prodhimi 3	*Integrimi i zinxhirit të furnizimit përmes zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla, në dy fushat e fokusit me kompanitë kombëtare dhe rajonale, do të përmirësoj mundësitë e vet-punësimit.*

Objektivat e përgjithshme në Prodhimin 3 pothuajse janë arritur. Prodhimin 3 ka pas një performancë shumë mirë gjatë këtij viti. Projekti do të bëjë disa ndryshime të vogla në aspektin e qëndrueshmërisë. Lidhja dhe bashkëpunimi ndërmjet zinxhirit furnizues me bizneset lokale dhe rajonale është përmirësuar dukshëm. Bizneset brenda dhe jashtë komunës së synuar kanë qenë të përfshira në mënyrë aktive në zhvillimin e programeve të trajnimit në bazë të nevojave të palës kërkuese. Pakoja e trajnimit është zhvilluar në bashkëpunim me bizneset, me qëllim të inkurajimit të investimeve për prodhuesit e interesuar.

Një numër i përgjithshëm prej 974 furnizuesve/prodhuesve në 6 zinxhirë të vlerave janë trajnuar në zhvillimin e aftësive. Projekti ka punuar me 4 zinxhirë të vlerave bujqësore (PMJD të egra dhe të kultivuara, fruta manore dhe pemë, bylmet dhe bagëti, mjaltë) dhe 2 zinxhirë të vlerave jo bujqësore (tekstil dhe artizanate, dhe shërbime) të cilat janë identifikuar gjatë hulumtimit të tregut, që është bërë në fillim të vitit.

Më shumë se 80% e furnizuesve janë të lidhur ose janë lehtësuar për të krijuar lidhje me blerësit lokal, pjesa tjetër prodhojnë dhe shesin produktet/shërbimet e tyre drejtpërdrejt në tregjet e hapura.

Nga objektivi vjetor, 59% e tyre janë femra (ndërsa janë synuar 50%). Grupet e pakicave kanë qenë të motivuara shumë, për të marrë pjesë ne programin e trajnimit, ku nga 250 sa janë synuar, interesim të lartë për t'iu bashkuar S4RE kanë shfaqur 310. Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, 270 prej tyre janë fermer të rinj, të cilët merren me zinxhirin e vlerës. Këta numra të furnizuesve janë organizuar në 62 grupe formale dhe joformale (janë synuar 60), dhe së bashku me bizneset lokale ata i identifikojnë nevojat e tyre (shih Shtojcën 1 dhe 4).

Objektivi	**Synimi**	**Arritjet**	**%**
Furnizuesit/fermerët	1000	974	**97%**
Grupet (formale/joformale)	60	62	**103%**
Pakicat (25% of 1000)	250	310	**124%**
Femrat (50% of 1000)	500	293	**59%**
Të ri (25% of 1000)	250	270	**108%**

Zonat rurale të komunës së synuar duken shumë premtuese për kultivimin e PMJD-ve. Së bashku me kompanitë lokale, janë përkrahur 51 përfitues me mbjelljen e 0.05 ha për secilin prej tyre, me kulture marshmelov i zi. Ky numër përfaqëson 51% të objektivit të përgjithshëm.

Projekti ka rritur bashkëpunimin me sektorin publik dhe privat, me qëllim të përmbushjes së pritshmërive të prodhuesve që kanë të bëjnë me investimet. Për këtë arsyeje, me blerjen e objekteve për tharje në vlere prej 3,700 Eurove është mbështetur një grup prej 21 përfituesve të cilët merren me PMJD.

80 përfituesit e projektit që kanë të bëjnë me bulmet/bagëti janë ndihmuar për të pas qasje të lehtë në grante (furnizimi me makina për mjelje) të ofruara nga komuna e Kamenicës. Komuna e Novobërdës ka mbështetur 20 përfitues të projektit me blerjen e pajisjeve për bujqësi (sektori i bletarisë, bulmetit/bagëtisë dhe sektori i pemëve).

Me materiale të trajnimit në marrëveshjen për ndarjen e shpenzimeve janë mbështetur tri grupe joformale të grave nga komuniteti serb me 50 përfitues (bulmet, prodhim të mjedrës dhe prodhim të mjaltit). Ujitja për më shumë se 4 ha është përmirësuar dukshëm, prodhimi i djathit vendor në zonat rurale është më cilësor, si dhe është rritur cilësia e mjaltit.

Ndërhyrja e mëtejshme është bërë për të mbështetur fermerët individual për të përgatitur propozimin e projektit dhe planet e biznesit për grantet e MBPZHR. Është bashkë-financuar përgatitja e 6 planeve biznesore dhe 2 prej tyre tanimë kanë marrë mbështetjen.

Implikimet e rezultateve dhe procesi për veprim në vitin e ardhshëm (drejtimi)
Projekti do të vazhdojë të punojë në 4 zinxhirë të vlerës bujqësore, ndërsa zinxhirët e vlerës jo-bujqësore do të vlerësohen në bazë të gjendjes së punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave për çdo zonë të veçantë. Strategjia e implementimit nuk do të ndryshojë, por do të bëhen më shumë përpjekje për të rritur bashkëpunimin me bizneset lokale dhe sektorin privat me qëllim të implementimit të paketave të trajnimit dhe investimet.

3.4 Prodhimi 4: Ngritja e kapaciteteve të ofruesve lokal të shërbimeve

Prodhimi 4	*S4RE do të mbështetë ofruesit lokal të shërbimeve, në dispozicion, për të ofruar shërbime të aftësimit dhe të trajnimit, që bazohen më tepër në trajnime praktike dhe në aktivitetet të lidhura me sektorin privat, dhe janë plotësuese të sistemit formal të AAP*
Projekti promovon aktivitete përmes uebfaqes dhe përmes faqeve të Fejsbukut. Ngjarjet, gurë themelet dhe publikimet përditësohen rregullisht. Është përditësuar baza e të dhënave të Projektit, ku janë menaxhuar të gjitha aktivitetet e projektit dhe monitorohen kontratat që kanë të bëjnë me personat e burimeve dhe ofruesit e shërbimeve. Kjo është dëshmuar të jetë një mjet shumë i dobishëm në gjurmimin e aktiviteteve dhe objektivave të projektit. Detajet e kontaktit dhe fusha e specialitetit të personave të burimeve dhe ofruesit e shërbimeve të angazhuar nga projekti janë në dispozicion në uebfaqen e projektit. Kjo i ka ndihmuar 3 personave të burimeve për të fituar punë jashtë e projektit (shih Shtojcën 1). Projekti synon angazhimin e ofruesve lokal të shërbimeve, për të siguruar shërbime lokale të përballueshme për qytetaret. Projekti për herë të parë ka angazhuar 24 persona të burimit si trajner. Në vitin 2014 janë mbajtur dy ngjarje të rrjetëzimit duke bërë së bashku të gjithë ofruesit e shërbimeve, personat e burimit, lehtësuesit dhe stafin për diskutim dhe ngjarje sociale.
Implikimet e rezultateve dhe procesi për veprim në vitin e ardhshëm (drejtimi**)**
Për shkak të vështirësive, për shkak të dallimit në mes të personave të burimeve dhe ofruesve të shërbimeve, u vendos që në vitin 2015 të gjithë ofruesit e shërbimeve që i ofrojnë shërbime Projektit dhe përfituesve të projektit, në mënyrë direkte apo indirekte, do të quhen “ofrues të trajnimit”.

3.5 Temat e tërthorta

- ***Gjinia:*** Projekti në të gjitha komponentët ka ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse për të nxitur barazinë gjinore, duke synuar 50% femra. Pjesëmarrja mesatare e femrave në nivel të projektit është 30%. Projekti do të vazhdojë implementimin e programeve të trajnimit me specifikë gjinore për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë. Në vitin 2014, projekti ka organizuar trajnim në floktari dhe rrobaqepësi për pesë grupe mësimore të rinisë femërore dhe për gra të martuara. Përveç floktarisë dhe rrobaqepësisë, gratë në komunat e synuara nuk e kanë vetëbesimin për të hulumtuar mundësitë e vetë-punësimit dhe gjetjen e punës në profesione tjera. Pjesëmarrja e femrave në grupet mësimore bujqësore ka qenë e ulët. Megjithatë, në vitin 2014 vetiniciativa e grupeve të femrave ka qenë në nivel të kënaqshëm. Tri grupe të mbështetura nëpërmjet fondit të mundësive kanë hapur biznese të vogla, në krahasim me vitin 2013 kur një iniciative e tillë nuk është shënuar.

  Përveç kësaj, projekti ka mbështetur dy biznese ekzistuese të cilat janë në pronësi të grave, për të zhvilluar biznesin e tyre përmes mbështetjes në marketing dhe trajnim në Prodhimin 2. Rezultati 3 ka lehtësuar tri grupe joformale të grave fermere në

kultivimin e mjedrës, bulmetit dhe bletarisë. Me mbështetjen e dhënë në trajnime dhe me disa pajisje, këto tri grupe kanë rritur cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të tyre. Lehtësimi dhe trajnimi mbi planin e biznesit dhe përpilimi i propozimit ka bërë të mundur që Ministria e Bujqësisë të jep grante për dy gra bletare. S4RE do të sigurojë që femrat të marrin pjesë më shumë në grupet mësimore të cilat janë aktive në sektorët premtues ekonomik, si në investimin në agrobiznes, në mundësitë e përpunimit. Për më tepër, do të promovohen më tutje grupet e përziera mësimore (në aspektin gjinor). Të dhënat e ndara sipas gjinisë mund të gjenden në fletën e monitorimit (shih Shtojcën 1).

- ***Qeverisja me fokusim në përfshirjen sociale:*** Aktivitetet e projektit S4RE promovojnë përfshirjen sociale të pakicave. Objektivi tregon se 25% e përfituesve të projektit janë nga radhët e pakicave. Pjesëmarrja e pakicave në nivel projekti është 33%. Tri grupe mësimore nga radhët e pakicave janë mbështetur në hapjen e bizneseve nëpërmjet fondit të mundësisë, një në rrobaqepësi, një në TI dhe një grup ka themeluar një fermë të derrave.

  Projekti, përveç ndikimit ne uljen e papunësisë, ka pas edhe një ndikim të madh social. Faktorët e butë lidhur me sjelljen e shumë të rinjve që jetojnë në komunat e synuara kanë ndryshuar. Zyrtarët komunal konfirmojnë se ka ndryshuar perceptimi ndaj aktiviteteve bujqësore. Është vërejtur një interesim i shtuar i të rinjve për të hyrë në agrobiznes. Përveç kësaj, për gratë të cilat jetojnë në zonat e largëta, projekti ka ndikuar në rritjen e integrimit të tyre dhe ka zvogëluar përjashtueshmërinë e tyre tradicionale nga jeta sociale.

4. Menaxhimi i Projektit

4.1 Menaxhimi i projektit siguron implementimin efikas të aktiviteteve, rritjen e zhvillimit të kapaciteteve të stafit dhe kapitalizimin e rezultateve

Monitorimi dhe Vlerësimi

Rëndësi e veçantë i është dhënë mbledhjes së rezultateve që lidhen me aktivitet e ndryshme të realizuara në vitin 2014 dhe 2013. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014, projekti vazhdon t'i përcjellë pyetësorët e anketës gjurmuese për përfituesit nga viti 2013 që lidhen me Prodhimin 1. Verifikimi i pavarur i rezultateve është bërë përmes anketimit me telefon, në përzgjedhjen rastësore të përfituesve.

Në 4 komuna u organizua Diskutimi i Grupit të Fokusit për përfituesit e Prodhimit 1 dhe 3. Për qëllimi ishte mbledhja e të dhënave cilësore mbi metodologjinë e përdorur dhe implementimin e përgjithshëm të projektit. Për më tepër, është kryer një studim i biznesit në mënyrë që të mblidhen informacione për t'i kuptuar më mirë rezultatet dhe ndikimet e përgjithshme të projektit të lidhura me Prodhimin 2 dhe 3.

Në tetor të vitit 2014, u realizua Rishikimi Afat-mesëm (MTR) i projektit. Objektivi i MTR-së ishte shqyrtimi i implementimit të përgjithshëm të projektit në krahasim me planet dhe objektivat, rishikimi i metodologjisë dhe qasjes, duke dhënë rekomandimin për implementimin e projektit për periudhën e mbetur të fazës aktuale, dhe për të dhënë rekomandim për zgjerimin eventual të projektit përtej vitit 2015.

MTR ka qenë shumë pozitiv në lidhje me implementimin e përgjithshëm dhe ka dhënë disa rekomandime të cilat mund të mbështesin projektin për përmirësimin e efektivitetit të përgjithshëm drejt implementimit dhe arritjes së objektivave të dëshiruara dhe të planifikuara.

Zhvillimi i kapacitetit të stafit

I gjithë stafi i projektit ka pas rastin për të udhëtuar jashtë vendit për udhëtime studimore. Menaxheri i Projektit (Luan Hoti) dhe Zyrtari i Projektit (Basri Pulaj) kanë vizituar Tanzaninë në muajin Prill, për të parë në veprim Grupet Mësimore në Programin Ti-Mëso (U-Learn Program), projekt ky i Swisscontact, e i financuar nga fondacioni MasterCard. Mimoza Mirashi

(Zyrtare e projektit) dhe Flutura Vidishiqi (Zyrtare Administrative), kanë ndjekur një trajnim që është mbajtur në muajin Maj në Holande për Facilitimin/Lehtësimin e Grupeve.

Përveç kësaj, projekti vazhdon të mbështetet nga këshilltarët ndërkombëtarë. Në janar dhe korrik janë realizuar vizita mbështetëse nga Këshilltari Ndërkombëtar i Projektit z. Stewart Pettigrew, me qëllim të përmirësimit të qasjeve të implementimit dhe Planit Vjetor të Veprimit (PVV), të rishikojë implementimin e projektit, si dhe të hartojë projektin "Raporti Gjysmë-Vjetor (RGjV).

Vizitat tjera të Këshilltarit Ndërkombëtar të Projektit z. Peter Porten nga HELVETAS Swiss Intercooperation janë realizuar në muajt Mars dhe Nëntor. Në muajin Nëntor, znj. Katharina Walker përkrahu projektin për përgatitjen e PVV-së për vitin 2015. Deri në fund të fazës së projektit, znj. Katharina Walker do të mbetet mbështetësja kryesore prapa projektit për zhvillim të aftësive dhe sektorit privat.

Në vitin 2014, S4RE ka angazhuar dy praktikantë, secili për një periudhë tre mujore. Praktikantët janë angazhuar në bazë të marrëveshjes me dy institucionet e arsimit; me Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit me seli në Mitrovicë, dhe me Kolegjin "Riinvest" me seli në Prishtinë.

Qëllimi i këtyre praktikave është që t'i ofrojë studentëve të vitit të fundit të studimeve përvojë praktike në punën e projektit, ndërsa në të njëjtën kohë të rris burimet e stafit për projektin. Suksesi i këtij aktiviteti në vitin 2014 ishte inkurajues, dhe ky aktivitet planifikohet të vazhdohet edhe në vitin 2015.

Raportimi dhe Promovimi i Projektit

Gjatë vitit 2014, janë zhvilluar një numër i ngjarjeve dhe takimeve për të promovuar aktivitetet dhe sukseset e S4RE. Në portal janë publikuar disa artikuj. Albinfo, një portal shumë i rëndësishëm i lajmeve për Diasporën shqipfolëse që jeton në Zvicër, e ka portretizuar S4RE dhe punën e saj në komuna. Në faqen e internetit të S4RE janë publikuar artikuj të tjerë dhe më të rejat e projektit, një numër i rasteve studimore, tregimet e suksesit, fletë-dëshmitë e projektit, si dhe janë shtypur broshura informuese të projektit.

Televizioni publik i Kosovës, RTK, ka bërë disa xhirime rreth aktiviteteve të ndryshme të projektit. Në programin e tyre të rregullt, nëpërmjet sistemit të transmetimit tokësor dhe satelitor janë paraqitur tregime interesante.

Menaxheri i Projektit ka vizituar Zvicrën në qershor të vitit 2014, dhe u takua me z. Fortunat Walther nga Fondacioni Medicor, me menaxhmentin e lartë të HELVETAS Swiss Intercooperation, si dhe me stafin e mbledhjes së fondeve. Qëllimi i kësaj vizite ishte për t'i informuar njerëzit kyç mbi rezultatet dhe performancën e projektit, dhe vizita ishte pritur mirë.

Në shtator të vitit 2014, stafi i S4RE ka vizituar projektin "Këshillimi drejt Punësimit" në Shqipëri, një projekt i Swisscontact i financuar nga Fondacioni Medicor. Kjo vizitë ishte një rast i mirë për shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave nga dy projektet, me shpresë për bashkëpunimin e ngushtë në të ardhmen ndërmjet dy projekteve.

4.4 Partnerët e Projektit

Partnerët kryesorë të projektit mbeten bizneset lokale dhe kombëtare, autoritetet lokale, qendrat publike të punësimit dhe QTP-të në komunat e përzgjedhura. Bashkëpunimi me partnerët e projektit është formalizuar me nënshkrimin e marrëveshjeve dhe janë implementuar disa aktiviteteve. Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka mundësuar bashkëpunimin me QTP në Prizren, për sigurimin e cilësisë së trajnimit për floktari në Dragash.

MM-të e nënshkruara me katër komunat ku projekti është aktiv, i ka mundësuar projektit dhe përfituesve të tij që të përdorin hapsirat e komunave si dhe përdorimin e burimeve natyrore.

Në aktivitetet e projektit marrin pjesë zyrtarët e komunave nga drejtoritë për rini, bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik.

Projekti vazhdon të ketë bashkëpunim të fuqishëm me organizata të ndryshme të cilat implementojnë projekte në komunat e përzgjedhura, p.sh. UNDP, Caritas dhe USAID-i përmes takimeve të rregullta dhe shkëmbimit të informacioneve për identifikimin e sinergjive dhe implementimin e aktiviteteve të përbashkëta.

5. Mësimet e nxjerra

Qasja pragmatike: Për të trajtuar detyrën sfiduese të përmirësimit të punësimit të të rinjve në zonat rurale duhet të përdoren një varg i mjeteve. Vazhdimi i promovimit të këtyre mjeteve, trajnimet për aftësim jetësor dhe teknik, dhe duke synuar përshtatje të vogla për implementimin e tyre, është qasja e dëshiruar për një projekt inovativ siç është S4RE. S4RE vazhdimisht ka trajtuar pengesat dhe sfidat drejt suksesit, duke gjetur mundësi të ndryshme për implementim.

Trajnimi praktik për t'iu përshtatur mundësive: S4RE vazhdon të fokusohet në trajnimin praktik, mundësisht që aktivitetet trajnuese të punës të përshtaten me mundësitë ekzistuese të bizneseve lokale. Kjo qasje është zhvilluar për të përfshirë më shumë trajnimin në vend të punës, që i mundëson bizneseve të vogla ngritjen e qasjes së tyre ndaj punëtorëve të kualifikuar, ndërsa në të njëjtën kohë paraqet një mundësi për të ardhura dhe punësim të një grupi më të gjerë të të rinjve. Kjo qasje e drejtpërdrejtë nuk është e mirë vetëm për bizneset, ajo gjithashtu është duke u treguar si me interesante për për të trajnuarit. Rezultatet kanë qenë shumë pozitive, siç tregohet nga fakti se bizneset tani janë duke iu afruar S4RE me ide të trajnimit.

Përshtatja e aktiviteteve me zonat e ndryshme të ndërhyrjes: Aktivitetet e integrimit nga zonat e ndryshme të ndërhyrjes janë treguar si të dobishme. Një shembull i mirë në këtë drejtim është Hit Flores nga Dragashi. Grupet Mësimore, aktivitetet e trajnimit dhe të zinxhirit të furnizimit, të gjitha janë realizuar me të njëjtin partner. Një përfitim shtesë ishte vënia e kontaktit me familjet të cilat furnizojnë kompaninë. Kompani të tilla ekzistojnë në disa sektorë, dhe S4RE duhet të punojë në drejtim të angazhimit me biznese, madje edhe kur ato mund të ndodhen jashtë zonës së projektit, por të cilat kanë lidhjet me to.

Zhvillimi i kapaciteteve të ekipit: Forcimi i njohurive dhe aftësive të ekipit të S4RE-it, me anë të trajnimit dhe shkëmbimit të vizitave, ka qenë gjithashtu e rëndësishme. Kosovën e kanë vizituar kolegët nga Nepali dhe Uganda, dhe dy anëtarë të ekipit të projektit vizituan Tanzaninë. Këto shkëmbime të vizitave kolegiale janë mënyra të shkëlqyeshme për të shpërndarë ide dhe njohuri, dhe duhet të inkurajohen edhe më tej, jo vetëm brenda S4RE, por në të gjitha projektet tjera.

Arritja e ndryshimeve të qëndrueshme në nivelin e punësimit dhe të ardhurave në rajonet e përzgjedhura do të mbetet një sfidë, pavarësisht nga rezultatet pozitive të arritura deri tani nga S4RE. Por qasja për të siguruar një fokus të fortë të sektorit privat me aftësitë që përputhen me nevojat e tyre është duke treguar se mund të arrihen rezultate, madje edhe në një mjedis të tillë të vështirë.

7. Buxheti

Buxheti i përgjithshëm i projektit për vitin 2014 ka qenë 457,108.00 CHF. Buxheti i përgjithshëm përfshin shpenzimet e përgjithshme për implementimin e projektit. Pjesa e buxhetit e cila ka të bëjë me stafin ndërkombëtar (konsulentët) menaxhohet nga Zyra Qendrore dhe paguhet në CHF (Franga Zvicerane), ndërsa shpenzimet lokale që përfshin Njësinë e Implementimit të Projektit (PIU) dhe Fondet e Administruara të Projektit (APF) menaxhohen në Euro. Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për shpenzimet lokale ka qenë 319,275.18 Euro.

Shpenzimet e përgjithshme te projektit ne vitin 2014 tejkalojnë planifikimin fillestare buxhetor për 2%.

Mbi-shpenzimet të cilat janë shfaqë për pajisjet e zyrave, e të cilat janë më të larta për 322% ose 1,109.78 Euro, janë shpenzime të cilat kanë të bëjnë me pajisje të disa projekteve, p.sh. kompjuterë, kamera për lehtësuesit e terrenit, dhe blerja e katër monitorëve për kompjuterët e stafit të projektit, që nuk ishin planifikuar fillimisht.

Nën-shpenzimet të cilat janë shfaqë në Prodhimin 5 (Menaxhimi i Projektit) kanë të bëjnë me shpenzimet e rishikimit afatmesëm të projektit të cilat ishin planifikuar fillimisht brenda Prodhimit 5, kurse në ndërkohë ishte marr vendimi që rishikimi afatmesëm do të kryhet nga burimet e brendshme të HELVETS-it. Shpenzimet e përgjithshme të cilat lidhen me rishikimin afatmesëm janë rezervuar brenda buxhetit që ka të bëjë me këshilltarët ndërkombëtar, buxhet i cili menaxhohet nga Zyra Qendrore.

8. Shtojcat

Shtojca 1: Fleta Monitoruese për S4RE.

Shtojca 2: Faktet dhe Shifrat për Prodhimin 1

Shtojca 3: Faktet dhe Shifrat për Prodhimin 2

Shtojca 4: Faktet dhe Shifrat për Prodhimin 3

Shtojca 5: Definimi i ‘Punësimit’ (Aktiviteti Ekonomik)

Shtojca 6: Raste Studimore dhe Histori Suksesi

Shtojca 7: Fotografi

Shtojca 1: Fleta Monitoruese për S4RE

HELVETAS Swiss Intercooperation Aftësitë për Punësim Rural (S4RE) – Fleta Monitoruese													
Treguesit i kuadrit të të dhënave	**Treguesi**	**2013**				**2014**				**2015**				**Totali 2013-2015**
		Objektivi 2013	**Gjysmë vjetori i parë**	**Gjysmë vjetori i dytë**	**Totali Vjetor**	**Objektivi 2014**	**Gjysmë vjetori i parë**	**Gjysmë vjetori**	**Totali Vjetor**	**Objektivi 2015**	**Gjysmë vjetori i parë**	**Gjysmë vjetori i dytë**	**Totali Vjetor**	**Totali**
1.1	# i grupeve mësimore të krijuara	10	15	1	16	30	25	34	59	40				
1.1	# i lehtësuesve të krijuar	8	7	0	7	0	6	0	6	0				
1.2	# i të rinjve të trajnuar të papunë	200	59	134	193	600	130	466	596	800				
1.2	# i grave të reja të trajnuara të papunësuara	100	33	57	90	300	35	122	157					
1.2	i % së grave të reja të papunësuara të trajnuara	(50% of 200)	56%	43%	47%	50%	27%	26%	26%	50				
1.2	# i të rinjve të papunë të trajnuar nga radhët e pakicave	50	21	25	46	150	67	146	213					

1.2	i % së të rinjve të trajnuar të papunë nga radhët e pakicave	(25% of 200)	36%	19%	24%	25%	52%	31%	36%	25				
1.3	# i të rinjve të papunë që kanë kaluar në vetëpunësim apo që janë punësuar pas trajnimit	120	4	43	47	360	14	318	332	60				
1.3	i % së të rinjve të papunë që kanë kaluar në vetëpunësim apo që janë punësuar pas trajnimit	(60% of 200)	7%	32%	24%	60%	11%	68%	56%	60				
1.3	# i MM të nënshkruar me partnerin IMF	1	0	0	0	1	0	0	0	1				
2.1	# i MM të nënshkruar me bizneset e sektorit privat	5	6	2	8	8	7	3	10	7				
2.2	# i punonjësve të bizneseve të mëdha të trajnuar (të rinj dhe ata ekzistues)	100	0	48	48	150	45	102	147	150				
2.2	# i punonjësve të rinj të trajnuar (bizneset e mëdha)	25	0	21	21	38	5	24	29	38				

2.2	i % së punonjësve të rinj të trajnuar (bizneset e mëdha)	(25% of 100)	0%	84%	84%	(25% of 150)	13%	63%	76%	25%				
2.2	# i punonjësve të trajnuar të NVM-ve (të rinj dhe ata ekzistues)	200	0	66	66	200	69	72	141	200				
2.2	# i punonjësve të rinj të trajnuar (NVM)	50	0	10	10	50	29	11	40	50				
2.2	i % së punonjësve të rinj të trajnuar (NVM)	(25% of 200)	0%	20%	20%	(25% of 200)	58%	22%	80%	25%				
2.3	# i kontratave të nënshkruara me ofruesit e trajnimeve për punonjësit	5	0	5	5	0	7	11	18	0				
2.3	# i kontratave të nënshkruara me ofruesit e trajnimeve për planifikim të biznesit	5	1	3	4	0	3	0	3	0				
3.1	# i ZV-ve të identifikuara dhe i MM të nënshkruara	6	4	0	4	0	2	0	2	0				
3.1	# i përfituesve të trajnuar – vjelja e PMJD-ve të egra	200	60	40	100	400	49	276	325	500				

3.1	# i përfituesve të trajnuar – PMJD-të e kultivuara	50	0	10	10	100	51	0	51	100				
3.1	# i përfituesve të trajnuar – Fruta manore dhe Pemë	100	105	3	108	100	51	47	98	100				
3.1	# i përfituesve të trajnuar – Bulmet dhe Bagëti	100	142	38	180	200	191	94	285	200				
3.1	# i përfituesve të trajnuar - Mjaltë	50	95	12	107	100	99	8	107	100				
3.1	# # i përfituesve të trajnuar – Tekstil dhe Artizanate	0	0	0	0	50	16	12	28	50				
3.1	# i përfituesve të trajnuar – Shërbime (TI/Financiare)	0	0	0	0	50	20	60	80	50				
3.2	# i grupeve furnizuese me aftësi të përmirësuara	30	29	2	31	60	32	30	62	60				
4.1	# i ofruesve të trajnimit të forcuar	4	2	13	15	3	11	34	45	3				
4.1	i % së ofruesve të trajnimit të angazhuar në projekte përveç të S4RE-së	(50% of 4)	0%	150%	150%	(50% of 3)	150%	0%	150%	50%				

Shtojca 2: Faktet dhe Shifrat për Prodhimin 1

Informacione të Monitorimit për Prodhimin 1, (2014)

Profesioni	Grupet Mësimore		Cikli i Trajnimit të Grupit		Planet Biznesore të Grupit		Përkatësia Etnike (Grupet)			Gjinia		Punësimi (Individët)[1]					
	Numri	Pjesëmarrësit	Në vazhdim e sipër	Të kryera	Në vazhdim e sipër	Të kryera	Shqip.	Serb.	Të tjerë	M	F	Me orar të plotë		Me orar të pjesshëm		Vet	
												M	F	M	F	M	
Rrobaqepësi	2	25	0	2	0	2	14	6	5	0	25	0	11	0	0	0	
Floktari	3	50	0	3	0	2	50	0	0	0	50	0	2	0	0	0	
Krasitje	1	7	0	1	0	0	7	0	0	7	0	0	0	0	0	0	
Bletari	9	116	0	9	0	8	54	5	11	107	9	0	0	0	0	83	
Teknik i thonjve	1	5	0	1	0	0	5	0	0	0	5	0	0	0	2	0	
Kamerierë	1	15	0	1	0	0	0	1	3	14	1	4	0	0	0	0	
Kultivim i zogjve	1	9	0	1	0	1	9	0	0	4	5	0	0	0	0	0	
Identifikim dhe grumbullim i PMJD	2	26	0	2	0	2	26	0	0	26		0	0	0	0	19	
Argjendari	1	12	0	1	0	0	0	4	8	0	12	0	0	0	0	0	
Video dizajn	2	18	0	2	0	1	6	0	12	11	7	4	0	2	0	0	
Zdrukthëtari	1	5	0	1	0	0	5	0	0	5	0	2	0	0	0	0	
Çanta dore	1	8	0	1	0	0	8	0	0	0	8	0	0	0	0	0	
Kultivim i dredhëzës	7	58	0	7	0	0	27	1	0	52	6	0	0	0	0	25	
Kultivim i Manaferrave	6	45	0	6	0	0	45	0	0	39	6	0	0	0	0	20	
TI	1	9	0	1	0	1	0	9	0	6	3	0	0	0	0	4	
Kultivim i Mjedrës	13	133	0	13	0	1	61	4	0	96	23	0	0	0	0	100	
Tapiceri	1	5	0	1	0	0	0	5	0	2	3	3	0	0	0	0	
Pastiçeri	2	21	0	2	0	1	0	8	13	13	8	0	2	0	0	0	
Kultivim i derrave	1	5	0	1	0	1	0	5	0	4	1	0	0	0	0	4	
Termoizolim	1	7	0	1	0	1	0	0	7	7	0	0	0	0	0	6	
Ngrohje qendrore	1	15	0	1	0	1	15	0	0	15	0	5	0	2	0	0	
Qebaptore	1	5	0	1	0	0	0	0	5	5	0	0	4	0	0	0	
Totali	**59**	**599**	**0**	**59**	**0**	**22**	**332**	**149**	**64**	**413**	**172**	**18**	**19**	**4**	**2**	**261**	

[1] Për më shumë informacione shih Shtojcën 5

Shtojca 2: Faktet dhe Shifrat për Prodhimin 2

Fakte dhe Shifra - Informacione të Monitorimit për Prodhimin 2, (2014)													
Komuna	Kompanitë	Fusha e trajnimit	Punonjës të trajnuar		Cikli i trajnimit		Përkatësia etnike			Gjinia		Punësimi (Individët)	
			Të rinj	Ekzistues	Në vazhdim e sipër	Të kryera	Shqip.	Serb.	Të tjera	M	F	Me orar të plotë	Me orar të pjesshëm
Dragash	Ferma Opoja	Ferma e pulave	8	3	0	11	11	0	0	11	0	3	8
	Connect lSP	Teknologjia Informative	0	11	0	11	11	0	0	11	0	11	0
	SHPK Hit Flores	Përpunimi i PMJD	21	24	0	45	45	0	0	34	11	10	35
	NVM-të	Menaxhimi i Biznesit	0	17	0	17	17	0	0	15	2	17	0
	NVM-të	Zhvillim i Planit të biznesit	0	3	0	3	3	0	0	3	0	3	0
	Shoqata e Biznesit	Promocion dhe promovim	0	10	0	10	10	0	0	10	0	10	0
Kamenicë	NVM-të	Plane të Biznesit dhe Marketing	0	43	0	43	43	0	0	27	16	43	0
	Termo Concept	Ventilim, ngrohje, etj.	6	2	0	8	8	0	0	8	0	4	4
	Tri Term	Sistemi i ngrohjes	7	2	0	9	9	0	0	9	0	4	5
	DPZ Tradita	Pastiçeri dhe ushqim	14	7	0	21	21	0	0	0	21	6	15
	Fat Bleta	Promocion dhe marketing	0	8	0	8	8	0	0	4	4	4	4
	NT Fungo Kos	Përpunimi i PMJD	0	23	0	23	23	0	0	7	16	4	19
	DPZ "Hana"	Termoizolim i shtëpive	4	4	0	8	8	0	0	8	0	6	2
	OJQ Take Action	Media dhe Komunikim	5	10	0	15	15	0	0	0	15	3	12
	SHPK Malësia	Menaxhim i Biznesit	0	6	0	6	6	0	0	4	2	6	0
	NPT HAKIU F & N	Përpunim i drurit	0	10	0	10	10	0	0	3	7	3	7
Novobërdë	KRS Komerc	Tapiceri	5	0	0	5	0	5	0	5	0	0	5
	SME	Zhvillim i Planit të biznesit	6	6	0	12	0	12	0	9	3	12	0
	NP Natyra	Përpunimi i PMJD	0	11	0	11	11	0	0	3	8	2	9
	SHPK Panorama Parku	Prodhim i Luleve	9	3	0	12	12	0	0	6	6	4	8
		Totali	**85**	**203**	**0**	**288**	**271**	**17**	**0**	**177**	**111**	**155**	**133**

Shtojca 2: Faktet dhe Shifrat për Prodhimin 3

Fakte dhe Shifra - Informacione të Monitorimit për Prodhimin 3, (2014)															
Komuna	Zinxhiri i Vlerës (ZV)	Grupet e trajnuara		Fermerët e trajnuar		Cikli i trajnimit		Përkatësia etnike (Pjesëmarrësit)			Gjinia (Pjesëmarrësit)		Punësimi (Individët)		
		Numri	Pjesëmarrësit	Të rinj	Ekzistues	Në vazhdim e sipër	Të kryera	Shqip.	Serb.	Të tjerë	M	F	Me orar të plotë	Me orar të pjesshëm	Vetë
Dragash	Turizëm	1	20	20	0	0	20	5	0	15	20	0	0	0	20
	Bylmet dhe Blegtori	4	75	0	75	0	75	53	0	22	75	0	0	75	75
	Mjaltë	2	35	0	35	0	35	0	0	35	35	0	0	35	35
	PMJD	6	124	66	58	0	124	119	0	5	124	0	0	124	124
	Artizanate	1	6	6	0	0	6	0	0	6	0	6	6	0	6
Shtërpcë	Pemë dhe Fruta Manore	5	72	56	16	0	72	17	55	0	35	37	0	72	72
	Bylmet dhe Blegtori	4	78	0	78	0	78	55	23	0	0	78	0	78	78
	Mjaltë	1	17	0	17	0	17	0	17	0	0	17	0	0	17
	PMJD	5	90	0	90	0	90	3	87	0	23	67	0	90	90
Kamenicë	Bylmet dhe Blegtori	7	128	0	128	0	128	124	4	0	124	0	80	44	128
	Pemë dhe Fruta Manore	1	18	0	18	0	18	18	0	0	18	0	0	18	18
	Plani i Biznesit	1	13	13	0	0	13	13	0	0	13	0	0	13	13
	Mjaltë	1	7	0	7	0	7	7	0	0	7	0	0	7	7
	PMJD	7	120	25	95	0	120	120	0	0	113	7	0	120	120
	Artizanate	2	22	22	0	0	22	22	0	0	0	22	0	22	22
	Produkte shtëpiake	5	47	40	7	0	47	42	5	0	0	47	0	47	47
Novobërdë	Mjaltë	4	48	1	47	0	48	18	30	0	41	7	0	48	48
	PMJD	3	42	13	29	0	42	39	3	0	40	2	0	42	42
	Pemë dhe Fruta Manore	1	8	8	0	0	8	6	2	0	6	2	6	2	8
	Bylmet dhe Blegtori	1	4	0	4	0	4	3	1	0	3	1	0	4	4
Total		**62**	**974**	**270**	**704**	**0**	**974**	**664**	**227**	**83**	**677**	**293**	**92**	**841**	**974**

Shtojca 5: Përkufizimi i " Punësimit " (Aktiviteti Ekonomik)

Treguesit sasiorë:

Të diplomuarit nga komponenti 1 i masave të trajnimit të SR4E do të punësohen kryesisht me përpjekjet për vetëpunësim, ndërsa paga-punësimi do të mbulojë vetëm një përqindje të ulët. Vetëpunësimi do të ndodhë kryesisht në fushën e agrobiznesit, i kufizuar nëpërmjet karakterit të tij sezonal. Për të gjetur treguesit të cilët përshkruajnë mirëqenien, duke pas parasysh realitetin e mundësive në zonën rurale të projektit, ne përdorim kriterin e të ardhurave.

Arsyetim:

- Paga minimale për të rinjtë sipas ligjit të punës së Kosovës është 130 euro në muaj për punësim me orar të plotë.
- Në mënyrë që të kemi parasysh karakterin sezonal të vendeve të punës, duhet përfshirë një tregues shtesë në lidhje me përkufizimin "me orar të pjesshëm". OBEZH e përcakton punën me orar të pjesshëm si punë me më pak se 30 orë në javë, që do të thotë më pak se 75% e një orari të zakonshëm të punës prej 8 orëve. Me fjalë të tjera, duke punuar 75% të orarit të zakonshëm të punës e më tepër, tregon se kemi të bëjmë me orar të plotë të punës të të punësuarit.

Llogaritja:

- Paga mujore minimale për të rinjtë, shumëzuar me 12 muaj, shumëzuar me 75%
- 130 EURO x 12 muaj x me 75% = 130 x 12 x 0.75 = 1170 euro në vit

Treguesi:

Duke marrë parasysh vetëpunësimin, **të ardhurat neto në vit prej 1000 euro** paraqesin të ardhura të mira dhe do të përdoret si tregues për punësim të suksesshëm.
Për më tepër, S4RE duhet të llogarisë të gjithë të diplomuarit që marrin pagën-punën ose të vetë-punësuarit sipas këtij pragu edhe nëse punësimi nuk është brenda fushës së trajnimeve. Në mënyrë që të bëhet vlerësimi i detajuara në lidhje me rëndësinë e trajnimit, monitorimi duhet të bëjë dallimin në mes "të diplomuarve që punojnë në përputhje me fushat e tyre të trajnimit" dhe "të diplomuarve që punojnë në fusha të tjera".

Treguesit cilësorë:

Trajnimi teknik është i kombinuar me trajnimin për aftësitë jetësore. Gjerë më tani, skema e monitorimit nuk e ka reflektuar këtë aspekt. Për këtë arsye, në skemën e monitorimit duhet të shtohet një tregues shtesë i cili jep një qëndrim të qartë në lidhje me aftësitë e fituara jetësore.

Treguesi:

Vlerësimi i të diplomuarve për rëndësinë e aftësive të fituara jetësore

Shkalla e vlerësimit

5 = ka kontribuar në masë shumë domethënëse
4 = ka kontribuar në masë domethënës
3 = ka kontribuar në masë të moderuar
2 = ka kontribuar në masë të vogël
1 = ka kontribuar në masë shumë të vogël
0 = nuk është arritur asnjë kontribut
n = nuk është planifikuar asnjë kontribut

Shtojca 6: Raste Studimore dhe Tregime të Suksesit

Rrobaqepësia në Kamenicë: Trajnimi për aftësim mundëson punësimin

Kompania DPZ ER-ROSI e udhëhequr nga Ibadete Sermaxhaj, është regjistruar si një dyqan rrobaqepësie pothuajse pesë vite më parë. Znj. Ibadete ka filluar të punoj vetëm, me një makinë të vetme rrobaqepësie. Fillimisht ajo e udhëhoqi biznesin e saj me disa prej konsumatorëve dhe ka punuar shumë për të rritur imazhin e saj dhe bazën e konsumatorëve. Ajo nuk kishte asnjë ndihmë nga projektet apo organizatat tjera, deri sa dëgjoi për Aftësitë për Punësim Rural (S4RE) dhe u interesua për të krijuar bashkëpunim me projektin.

S4RE lehtësoi themelimin e një Grupi Mësimor dhe znj. Ibadete ofroi arsimim profesional në rrobaqepësi për një grup prej 14 vajzave. Ato ndoqën një trajnim 3 mujor dhe gjithashtu patën mundësinë për të punuar dhe për të krijuar të ardhura përmes biznesit. ER-ROSI mbuloi koston e trajnimit dhe disa nga shpenzimet për transportin e grupit. Në përfundim të trajnimit, ER-ROSI ka qasje në një fuqi punëtore të trajnuar të aftë për të filluar rrobaqepësinë në nivel të pranueshëm për klientët e saj.

Gjatë programit të trajnimit, vajzat fituan aftësi dhe njohuri jo vetëm në rrobaqepësi. Ato mësuan se si të përdorin dhe mirëmbajnë pajisjet, të punojnë si shitëse, mësuan se si të bëjnë oferta dhe të bëjë porosi, dhe poashtu mësuan për marrëdhëniet me konsumatorët.

Aftësitë për marrëdhëniet me konsumatorët, të fituara gjatë trajnimit, i mundësuan dy vajzave që të gjejnë punë të tjera, jashtë profesionit të rrobaqepësi. Dymbëdhjetë anëtaret e grupit kanë vazhduar të punojnë në ER-ROSI dhe ato janë shumë të lumtura dhe të kënaqura me mundësinë e dhënë nga S4RE.

Programi i trajnimit ka qenë shumë i suksesshëm, dhe vullneti për të fituar njohuri në lidhje me këtë profesion bëri që pronarja e ER-ROSIT të jetë e lumtur që në fund të trajnimit të punësojë të trajnuarat. Sipas Ibadete Sermaxhaj, gjatë kohës së trajnimit, biznesi ishte në gjendje për t'iu përgjigjur një numri të madh të klientëve, që i priu rritjes së të ardhurave për biznesin.

Më shumë klientë do të thotë më shumë të punësuar, dhe më shumë të punësuar do të thotë më pak papunësi në regjion.

Njëra prej përfitueseve të projektit, Afërdita Lecaj, tha: “Trajnimi na ka ndihmuar për të mësuar shumë gjëra dhe për të gjeneruar të ardhura. Unë isha në gjendje të mbështes familjen time me rreth 150 euro në muaj. Ne kurrë nuk kemi menduar se në fund do të jemi kaq të kënaqura".

Tregim Suksesi

Bashkëpunimi mund të sjell mundësi punësimi

Më shumë se 60% e popullsisë së Kosovës janë të moshës 18-35 vjeçare, por mundësitë për të rinjtë që të angazhohen në punësim janë të pakta.

Trajnimi në vend të punës është një rrugë për nxënësit që të fitojnë përvoja të çmueshme dhe të përmirësojnë shanset e tyre për punësim. Megjithatë, ekzistojnë vetëm disa shkolla të cilat ofrojnë trajnime të tilla për nxënësit, kryesisht shkollat teknike.

Punët si instalimi i sistemit të ngrohjes, kërkojnë jo vetëm teori, por edhe praktikë. Bujar Kryeziu, pronar i Tri-Term, një biznes i vogël për instalimin e ngrohjes, pa një mundësi për të zgjeruar punën e tij duke i angazhuar nxënës me njohuri teorike, por jo edhe me përvojë praktike.

Biznesi i z. Kryeziut në Kamenicë funksionon qe 5 vite dhe ka 2 punonjës.

Ai ka dëgjuar nga një pjesëmarrës tjetër për projektin Aftësitë për Punësim Rural (S4RE) dhe mendoi se mund të angazhonte në projekt disa nxënës të shkollave të mesme përmes biznesit të tij. Ai ra në kontakt me 5 nxënës të motivuar dhe i mori në punëtorinë e tij për të filluar trajnimin në vend të punës.
Trajnimi ofruar nga z. Kryeziu dhe mbështetur nga S4RE, bëri të mundur që këta nxënës të bëjnë praktikisht atë që kanë mësuar në shkollë dhe gjithashtu u ofroi atyre një vend pune pas përfundimit të trajnimit.

Sipas Bujar Kryeziut, trajnimi mori 2 muaj që pjesëmarrësit të mësojnë bazat e nevojshme të instalimit të ngrohjes, dhe vetëm një muaj pas trajnimit ata ishin në gjendje për të punuar vet në punëtori. Ata ishin në gjendje për të blerë materiale, të bëjnë porosi dhe të bëjnë instalimin e plotë të ngrohjes. Trajnimi në vend të punës i ka ndihmuar atyre që të punojnë gjatë pushimeve verore dhe gjithashtu për të fituar më shumë përvojë.

Pasi që ata i zhvilluan këto aftësi, tre nga të trajnuarit filluan të punojnë vazhdimisht tek Tri-Term. Një prej të trajnuarve të tjerë vendosi të hapë biznesin e vet dhe tjetri punon me orar të pjesshëm me kompaninë.

Projekti S4RE jo vetëm që i ndihmoi të trajnuarve që të angazhohen në zhvillimin e vetes së tyre, por edhe i ka ndihmuar edhe Bujar Kryeziut për të rritur biznesin e tij. Tani për te është më e lehtë për të menaxhuar kompaninë, ndërsa ai mund të shkojë dhe të kryej punë të tjera, duke ju besuar këtyre të trajnuarve në punëtori. Ata janë shumë të lumtur dhe të ngazëllyer që e patën këtë mundësi.

"Në fillim menduam se do të ishte vetëm një trajnim ku pjesëmarrësit mund të mësonin gjëra dhe të bëjnë praktikën. Ne nuk besuam se në fund do të kemi këto rezultate. Unë dhe djemtë jemi shumë të lumtur për mundësinë e dhënë nga projekti S4RE dhe jemi duke punuar në drejtim të zgjerimit të biznesin".

Bujar Kryeziu, Tri-Term

Programe për të rinjtë për të lehtësuar punësimin

Historiku

Një ekonomi në rritje dhe mjedisi i qëndrueshëm biznesorë, janë kërkesat bazë për investime dhe për krijimin e vendeve të punës. Qasja në energji dhe në infrastrukturë, dhe një fuqi punëtore e kualifikuar janë gjithashtu të rëndësishme. Shumë prej këtyre kërkesave bazike janë një sfidë. Zonat si ajo e Dragashit, kanë vështirësi, veçanërisht në krijimin e punësimit për të rinjtë.

Ndërhyja nga S4RE

Përderisa një projekt i shkallës së S4RE nuk mund t'i zgjidhë të gjitha këto çështje, rritja e mundësive për të rinjtë që të hyjnë në tregun e punës mund të forcohet duke përmirësuar aftësitë e tyre.

Përpunimi i mishit kërkon aftësi të veçanta për përgatitjen dhe punën me këto produkte. Bizneset në rajonin e Dragashit janë të njohura për recetat e shijshme të mishit.

Vera është një sezonë veçanërisht e ngarkuar, për shkak të komunitetit të Diasporës që vizitojnë familjet e tyre dhe turistëve që vizitojnë Malet e Sharrit. Sevdil Mehmeti ka punuar në një qebaptore në Mal të Zi, dhe në vitin 2012 është zhvendosur në Dragash ku ka hapur biznesin e tij. Duke e parë kërkesat në rritje për qebaptore, z. Mehmeti po kërkonte mundësinë e hapjes së një dyqani tjetër. Megjithatë, një pengesë e shfaqur ishte fuqia punëtore e kualifikuar, në mënyrë që ta kap tregun gjatë pikut të sezonit. Takimi me stafin e Aftësitë për Punësim Rural (S4RE) ishte një rast i mirë për pronarin e biznesit që t'i shpreh nevojat e tij. S4RE e ndihmoi për të gjetur një grup të të rinjve lokal, që ishin të gatshëm të mësojnë dhe të hyjnë në tregun e punës.

Trajnimi ka filluar para sezonit veror, në mënyrë që t'i përgatisë ata kur te fillojë sezona. Projekti ka ofruar një trajnim 9 ditor për 5 të rinj që kanë fituar aftësi në përpunimin e produkteve të mishit si hamburgerë, salsiçe dhe qebapë. Ky është një biznes konkurrues, dhe DPH Lezeti e kuptoi se aftësitë më të mira të stafit të ri do t'i sigurojnë atij një avantazh konkurrues.

Rezultatet e bashkëpunimit

Bashkëpunimi me DPH Lezeti rezultoi që 4 persona nga grupi i trajnimit të fillojnë punën. Organizimi i të rinjve dhe përmirësimi i aftësive të tyre përmes trajnimit dhe përvoja praktike është duke u dëshmuar si një model i suksesshëm për të përmirësuar jetesën për të rinjtë në Dragash.

Sipas Rushid Rushitit i cili ishte i papunë për 2 vite, trajnimi i ndihmoi atij për të mësuar shumë gjëra në lidhje me këtë biznes. Tani pasi që ai ka një punë, është në gjendje gjithashtu për ta ndihmuar familjen e tij. Programet aktive për të rinjtë janë një mënyrë shumë e rëndësishme për uljen e papunësisë, dhe në qoftë se ka më shumë mundësi punësimi që do të jenë në dispozicion për të rinjtë, kjo ka potencial për të reduktuar migrimin nga zonat rurale në qendrat urbane.

Zvogëlimi i papunësisë së të rinjve

Historiku

Papunësia e lartë tek të rinjtë në Dragash është rezultat i numrit të vogël të punëdhënësve që rekrutojnë të rinj, duke rezultuar në më pak mundësi për të rinjtë që të hyjnë në tregun e punës. Trajnimi në vend të punës që mund të marrë formën e stazhit të punës, praktikës, ose mësimit duke punuar, mund të ndihmojë në lehtësimin e këtij kufizimi. Aftësitë për Punësim Rural (S4RE) është duke punuar në reduktimin e varfërisë duke rritur punësimin e të rinjve. Kjo kërkon bashkëpunimin në mes të projektit, bizneseve dhe nganjëherë të shkollave.

Ndërhyrja

Për analizimin e nevojave të kësaj fushe, S4RE ka bashkëpunuar me një trajner me përvojë dhe sipërmarrës në ofrimin e trajnimeve për një grup të të rinjve që ishin të etur për të mësuar në lidhje me instalimin e ngrohjes qendrore. Një grup prej 15 të rinjve kanë ndjekur pjesën teorike të trajnimit e cila ka ofruar njohuri se si të llogariten, të instalohen, dhe të prehen gypat e ngrohjes.

Për të nxitur të mësuarit e të rinjve dhe për të integruar njohuritë teorike në praktikë, të rinjtë kanë fituan aftësi praktike për të punuar me një komunitet profesionistësh. Të ndarë në dy grupe, ata kane ushtruar të mësuarit e tyre në kompanitë private që operojnë në Dragash dhe Prizren, duke iu mundësuar atyre që të lidhen direkt me tregun e punës. Pjesa praktike e trajnimit i ka motivuar pjesëmarrësit, duke dëshmuar të jetë një mënyrë e suksesshme për të rinjtë për të gjetur punë. Ajo ka rritur aftësitë e tyre për të bërë instalimin e ngrohjes qendrore, dhe ajo që është më kryesore ata mësuan gjithashtu se si të merren me klientët.

Rezultati final

Si rezultat, grupi gjeti veten më të sigurt në atë që ata bëjnë, për shkak të ofrimit të trajnimit teorik. Trajnimi në vend të punës i inkurajoi ata që të hapin bizneset e tyre. Shtatë të rinj nga grupi janë punësuar pas trajnimit, duke përfshirë dy që punojnë me orar të pjesshëm.

Shkëndim Bislimi dhe Reis Ahmeti u bënë shumë të suksesshëm gjatë trajnimit dhe më pas. Ata mësuan se si të kryejnë instalimin e plotë të ngrohjes dhe u profesionalizuan në këtë fushë. Ajo që i bëri ata me të vërtetë të ngazëllyer në lidhje me trajnimin, ishte certifikimi që ata do të merrnin në fund të një punë të bërë mirë.

"Kjo është një mundësi e mrekullueshme për të rinjtë, për të fituar aftësi dhe për të gjetur punë. Prandaj, unë do ta rekomandoj projektin fuqimisht që të vazhdoj t'i ndihmoj të rinjtë në Dragash, të cilët kanë mundësi shumë të kufizuara".

Reis Ahmeti

TURIZMI NË DRAGASH – Mundësitë e punësimit duke mësuar se si të drejtojmë një biznes

Si një zonë e pasur me bukuri natyrore, Dragashi është i njohur për potencialin e tij turistik. Megjithatë, janë shfaqur vetëm disa nisma në këtë sektor, dhe turizmi në 5 vitet e fundit ka qenë kryesisht i lënë pas dore. Një zonë që praktikisht nuk ka marrë asnjë mbështetje, ka qenë zona e zhvillimit të aftësive për operatorët lokalë të turizmit.

Nuk ka asnjë kompani apo biznes që drejtpërdrejt promovon turizmin në Dragash, vetëm disa hotele apo restorante që në mënyrë indirekte promovojnë turizmin. Si një oazë e bukurisë së paprekur natyrore, me florë dhe faunë të gjerë, si dhe me tradita kulturore, Dragashi është një vend shumë i rëndësishëm për projektin Aftësitë për Punësim Rural (S4RE).

Për shkak të kësaj analize të nevojave, projekti S4RE ka filluar identifikimin e personave e burimeve vendorë, që janë në gjendje për të kontribuar në zhvillimin e turizmit, dhe kontaktoi z. Suad Tosunin, që kishte përvojë të mjaftueshme në turizëm.

Ky aktivitet ka filluar duke plotësuar dokumentacionin që kërkohet nga projekti, përfshirë materialet e trajnimit. Të rinjtë u informuan nëpërmjet njoftimi publik në secilën zonë të Dragashit dhe të gjithë ata që kanë aplikuar janë pranuar. Një grup prej 20 të rinjve morën pjesë në trajnimin 10 ditor të ofruar nga z. Tosuni dhe mbështetur nga projekti S4RE. Trajnimi u bazua në punën e drejtpërdrejtë dhe programet interaktive. Pjesëmarrësit mësuan shumë për turizmin, duke përfshirë metodat e udhëheqjes se grupit turistik. S4RE ofroi lehtësira për trajnim, si dhe ndihmoi rreth kostos së trajnimit.

Në fund të trajnimit, çdo pjesëmarrës hyri në një provim përfundimtar për të shfaqur aftësitë dhe njohuritë që i kanë fituar gjatë trajnimit.

Qasja e S4RE në zhvillimin e aftësive, ku trajnimi është ofruar nga ekspertët e sektorit në kontekstin e biznesit, është parë si një mjet i veçantë për të rinjtë për të hyrë në biznesin privat.

Si rezultat përfundimtar, 3 persona nga grupi kanë filluar të punojnë në këtë biznes, duke ofruar shërbime si ciceron, punë për të cilën ata fitojnë nga 30 deri në 60 euro në ditë. Katër pjesëmarrësit e tjerë janë në proces të aplikimit për punë me bizneset turistike në rajon.

S4RE po vazhdon të punojë me këtë grup, duke u përpjekur që t'i lidha ata me biznese të tjera lokale si restorante dhe hotele, në mënyrë që të krijohen vende të reja pune.

Kultivimi i Produkteve Malore Jo-Drusore (PMJD) ndihmon në rritjen e të ardhurave dhe punësimin

Historiku

Kamenica është një komunë multietnike, në veri-lindje të Kosovës. Me rreth 5.000 të rinj, burra dhe gra të papunësuar Aftësitë për Punësim Rural (S4RE) ka identifikuar Kamenicën si një zonë të rëndësishme për rritjen e të ardhurave dhe mundësive të punësimit.

Kamenica ka kushte të favorshme për bujqësi, dhe një grup e fermerëve të rinj ishin të interesuar për të investuar në mënyrë që ti rrisin të ardhurat e tyre dhe të krijojnë mundësi punësimi.

Ndërhyrja nga S4RE

Fermerët për herë të parë dëgjuan nga S4RE për mundësinë e rritjes së marshmallovit të zi, si një bimë mjekësore. Pas disa takimeve me fermerët, S4RE në bashkëpunim me SH.P.K Agro Produkt, një përpunues i PMJD-ve në Kosovë, bashkuan forcat për të përkrahur 21 fermerë. Kjo mbështetje ka përfshirë një program trajnimi 3 mujor për kultivimin e të vjelave, si dhe i ka dhuruar 3.000 fidane secilit fermer për krijuar të mbjellat e tyre.

Lideri i grupit, z. Nexhmedin Kryeziu u përkrah më tej nga S4RE për te paraqitur një propozim në emër të grupit komunës së Kamenicës që të ofrojnë ndihmë në blerjen e një objekti për tharjes. Një grant në vlerë prej 3,675.00 eurove i është dhënë grupit që iu ka mundësuar atyre tharjen e produktit para se të shitet, duke arritur një çmim më të lartë.

Si pjesë e trajnimit, fermerët janë lehtësuar për të arritur një kontratë për shitjen e produkteve të tyre dhe për të rritur aftësitë e tyre të biznesit, duke i prirë një gatishmërie të madhe për të vazhduar me këtë aktivitet bujqësor.

Rezultatet e bashkëpunimit

Si rezultat i këtij bashkëpunimi, janë 21 fermerë që prodhojnë marshmallov të zi. Pavarësisht kushteve të këqija të motit gjatë sezonit të rritjes, që ka shkaktuar reduktimin e rendimentit potencial, fermerët janë të kënaqur me sasinë e mbledhur dhe secili prej tyre i ka angazhuar 2 të rinj në procesin e vjeljes.

Z. Kryeziu ka vjelur dhe shitur 75 kg lule të thata të marshmallovit të zi në vlerë prej 10 euro për kilogram.

S4RE i ka lidhur fermerët me 2 pika lokale të grumbullimit në rajonin e Kamenicës, të cilët kanë grumbulluar produktin përfundimtar prej tyre dhe e shitën tek Agro Produkt. Si rezultat i këtij bashkëpunimi të suksesshëm, marshmallovi i zi i rritur në Kamenicë tani është duke u shitur në një varg të produkteve natyrore në Gjermani dhe Zvicër!

Grupi origjinal i fermerëve ka formuar 2 grupe të reja të kultivuesve lokalë, që do të ndjekin trajnimet në vitin 2015 dhe janë të gatshëm për të investuar në kultivimin e PMJD-ve. Fermerët janë shumë të lumtur për këtë mundësi të ofruar nga S4RE dhe Agro Produkt. Kjo është hera e parë që një projekt ka investuar me ta në prodhimin e PMJD-ve, dhe u dha mundësinë për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme dhe punësim për familjet e tyre dhe komunitetin.

Rritja e cilësisë së produkteve dhe mundësitë e punësimit për kompanitë vendore

Historiku

I pasur me burime natyrore, Dragashi është i mirënjohur për malet dhe pyjet e saja të largëta. Ky peizazh natyror prodhon fruta të egra pyjore dhe kërpudha, të cilat përfaqësojnë të ardhura shumë të rëndësishme dhe mundësi punësimi për popullatën vendore. Familjet këtu kanë mbledhur kërpudha me breza të tërë për konsum personal, dhe që nga vitet e '90-ta disa biznese kanë eksportuar këto të vjelura në një varg të tërë të tregjeve.

Ndërhyrja

Z. Nuredin Bajrami, Kryeshefi i organizatës Hit Flores, thotë se: "Ideja për të mbledhur fruta të egra pyjore erdhi në vitin 2005 duke u bazuar në burimet e Maleve të pasura të Sharrit". Kompania e tij ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme joqeveritare, dhe biznesi është zhvilluar fuqishëm. Megjithatë, në rajonin e Dragashit është vështirë për tu gjetur stafi i kualifikuar. Si rezultat, Hit Flores bashkoi përpjekjet e tyre me projektin Aftësi për Punësim Rural (S4RE) në zhvillimin e stafit të tyre për përpunimin e kërpudhave.

S4RE organizoi 4 ditë trajnimi për 45 të punësuar, prej të cilëve 25% ishin gra. Meqenëse biznesi është zgjeruar viteve të fundit, 20 prej këtyre të punësuarve poashtu ishin të rinj. Trajnimi në vend të punës u ndihmoi atyre që të mësojnë për identifikimin, klasifikimin, pastrimin, përpunimin dhe paketimin e kërpudhave.

Rezultatet e bashkëpunimit

Ky bashkëpunim i projektit S4RE dhe Hit Flores rezultoi me një staf shumë më profesional që tani ka më shumë njohuri, e që pasoi me një produkt përfundimtarë me cilësi më të lartë dhe me rritje të shitjes në tregjet e eksportit. Në vitin 2014, janë eksportuar 15 ton të kërpudhave të ngrira.

Disa nga 20 punonjësit e rinj të trajnuar janë angazhuar me parë nga Hit Flores si punëtorë ditorë. Në vitin 2014 ata janë punësuar si punëtorë sezonal, duke fituar të ardhura më të qëndrueshme.

Fatlind Neziri, i cili është i angazhuar në sektorin e paketimit të frutave pyjore, kërpudhave dhe bimëve aromatike, është një nga punonjësit i cili tregon se projekti u ka ndihmuar atyre shumë. Ata kanë përmirësuar njohuritë e tyre dhe me këtë ata kanë rritur cilësinë e produkteve, dhe tani ata janë gjithashtu në gjendje t'i mësojnë familjet e tyre se si të identifikojnë e të mbledhin kërpudha, poashtu si një biznes familjar.

Rritja e kapaciteteve të Hit Flores është duke rezultuar në përdorimin e burimeve natyrore nga më shumë familje të zonës, duke mbledhur kërpudha dhe fruta manore. Pjesëmarrësit në trajnim shfaqën dëshirën se do të ketë edhe më shumë trajnime jo vetëm në lidhje me kërpudha, por edhe në lidhje me grumbullimin e produkteve të tjera të egra malore jo-drusore.
Përveç kësaj, kjo veprimtari përgëzon punën e ndërmarrë nga S4RE në vitin 2013 dhe 2014, duke punuar në prodhimin e mjedrës në rajonin e Dragashit. Hit Flores shpreson të grumbullojë mjedra nga 100 hektarë të mbjellur dhe kultivuara në 3 deri në 5 vitet e ardhshme.

Shtojca 7: Fotografi

LG Bletaria, Shtërpcë

LG Argjendaria, Kamenicë

Përpunimi i këpurdhave

Termo-izolimi

Grupi Goran i Artizanaleve

Prodhimi i Mjedrës, Shtërpë

TiT për lehtësuesit mësues dhe ofruesit e trajnimit